ASCAP

ASCAP
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

MODUL KURRIKULAR

Kurrikula në Bazë Shkolle ose me Zgjedhje në Arsimin e Mesëm të Lartë

SIGURIA KIBERNETIKE DHE QYTETARIA DIGJITALE

Koordiantor: Eriksen Mersinllari

www.ascap.edu.al

2026

MODUL KURRIKULAR

KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE / ME ZGJEDHJE NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

"SIGURIA KIBERNETIKE DHE QYTETARIA DIGJITALE"

I. HYRJE

Moduli kurrikular "***Siguria kibernetike dhe qytetaria digjitale***" është hartuar në përputhje me parimet dhe drejtimet themelore të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar dhe Kurrikulës Bërthamë të Arsimit të Mesëm të Lartë, të cilat vendosin në qendër zhvillimin e kompetencave kyçe, përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë, edukimin qytetar dhe mirëqenien e nxënësve në mjedisin digjital. Nxënësit e klasës së dhjetë janë përdorues aktivë të internetit, të rrjeteve sociale, të platformave të komunikimit, të aplikacioneve të ndryshme dhe të shërbimeve digjitale që lidhen me jetën e tyre të përditshme, me të nxënit dhe me ndërveprimin shoqëror. Në këtë fazë, ata jo vetëm konsumojnë përmbajtje digjitale, por edhe e krijojnë, e shpërndajnë dhe ndikohen prej saj. Për këtë arsye, krahas aftësive teknike, ata kanë nevojë të zhvillojnë aftësi më të thelluara për të kuptuar rreziqet që lidhen me sigurinë kibernetike, mbrojtjen e privatësisë, verifikimin e informacionit, etikën e komunikimit dhe qytetarinë digjitale.

Qëllimi i modulit është të pajisë nxënësit me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për të përdorur teknologjinë në mënyrë të sigurt, kritike dhe etike, për të kuptuar dhe analizuar kërcënimet më të zakonshme në mjedisin online, për të mbrojtur llogaritë, të dhënat dhe pajisjet e tyre, si dhe për të reaguar në mënyrë të përgjegjshme ndaj situatave problematike në mjedisin digjital.

Në këtë kuadër, moduli synon:

- zhvillimin e të kuptuarit mbi identitetin online, gjurmën digjitale dhe ndikimin që prania në internet ka në reputacionin personal dhe shoqëror;
- njohjen dhe analizimin e kërcënimeve më të zakonshme kibernetike, si phishing-u, malware-i, profilet e rreme, manipulimi social, bullizmi kibernetik dhe cenimi i privatësisë;
- formimin e aftësive praktike për mbrojtjen e llogarive, fjalëkalimeve, të dhënave personale dhe pajisjeve digjitale;
- zhvillimin e aftësive për verifikimin e informacionit, dallimin e dezinformimit dhe përdorimin kritik të mediave dhe rrjeteve sociale;
- ndërgjegjësimin për të drejtat, përgjegjësitë dhe parimet etike që lidhen me qytetarinë digjitale dhe përdorimin e teknologjisë;

- nxitjen e reagimit të sigurt dhe të strukturuar ndaj incidenteve digjitale, përfshirë raportimin, kërkimin e ndihmës dhe ndërtimin e zakoneve të qëndrueshme të higjienës kibernetike;
- fuqizimin e nxënësve për të bashkëpunuar në nisma dhe produkte ndërgjegjësuese që promovojnë sigurinë digjitale në shkollë dhe në komunitet.

Moduli ka karakter praktik, reflektues dhe ndërdisiplinor, ai zhvillohet përmes veprimtarive si analiza rastesh, diskutime të drejtuara, simulime, punë në grup, produkte ndërgjegjësuese dhe reflektim individual, duke krijuar mundësi që nxënësit të zbatojnë njohuritë në situata të afërta me realitetin e tyre. Në këtë mënyrë, moduli nuk synon vetëm përvetësimin e informacionit, por zhvillimin e aftësisë për të menduar në mënyrë kritike, për të marrë vendime të informuara dhe për të vepruar me përgjegjësi në mjedisin digjital.

Moduli mund të zbatohet në klasën e dhjetë, duke u përshtatur me kontekstin e shkollës, interesat e nxënësve dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e teknologjisë dhe të sigurisë kibernetike. Në këtë kuadër, siguria kibernetike trajtohet jo vetëm si një çështje teknike, por edhe si një dimension i rëndësishëm i qytetarisë digjitale, etikës, mirëqenies dhe pjesëmarrjes së vetëdijshme në mjedisin virtual.

2. PËRMBAJTJA E MODULIT

Moduli është strukturuar në shtatë tematika të ndërlidhura, të cilat trajtojnë në mënyrë progresive aspekte të ndryshme të sigurisë kibernetike dhe qytetarisë digjitale. Përmbajtja e tij ndërtohet mbi njohuritë dhe përvojat paraprake të nxënësve në përdorimin e teknologjisë dhe mjedisit digjital, duke i thelluar ato në drejtim të identitetit dhe reputacionit online, kërcënimeve kibernetike, mbrojtjes, verifikimit të informacionit dhe etikës digjitale. Në vijim, moduli adreson reagimin ndaj incidenteve dhe përfshirjen aktive të nxënësve në veprimtari ndërgjegjësuese për komunitetin shkollor, duke kulmuar me realizimin e një produkti final me vlerë praktike dhe edukative.

Në tematikën "Ekosistemi digjital, identiteti online dhe gjurma digjitale", nxënësi analizon mënyrën se si ndërtohet dhe projektohet prania e tij në internet, duke reflektuar mbi informacionin që publikon, mbi të dhënat që ruhen, mbi audiencën që mund t'i aksesojë ato dhe mbi mënyrën se si kjo prani mund të interpretohet nga të tjerët. Në këtë kuadër, trajtohen konceptet e identitetit online, gjurmës digjitale aktive dhe pasive, reputacionit digjital dhe kufirit ndërmjet hapësirës private dhe asaj publike. Tematika synon të zhvillojë te nxënësi

kuptimin se çdo veprim në mjedisin digjital lë pasoja dhe se sjellja online ndikon drejtpërdrejt në marrëdhëniet shoqërore, mirëqenien personale dhe mundësitë e ardhshme.

Në tematikën "Kërcënimet kibernetike dhe llojet e sulmeve", nxënësi njihet me kërcënimet më të zakonshme me të cilat mund të përballet një i ri në mjedisin online, si malware, phishing, profile të rreme, mashtrime me oferta ose shpërblime, manipulimi social, bullizmi kibernetik dhe cenimi i llogarive. Përmes trajtimit të këtyre çështjeve, nxënësi aftësohet të identifikojë shenjat paralajmëruese të rrezikut, të dallojë mekanizmat dhe taktikat e manipulimit dhe të kuptojë pse faktori njerëzor përbën një nga hallkat më të ndjeshme të sigurisë digjitale.

Në tematikën "Mbrojtja e llogarive, fjalëkalimeve dhe të dhënave personale", nxënësi fokusohet në praktikat themelore të mbrojtjes së sigurisë personale në mjedisin digjital. Në këtë kuadër trajtohen çështje që lidhen me krijimin e fjalëkalimeve të forta, përdorimin e fjalëkalimeve të ndryshme për llogari të ndryshme, autentikimin me dy faktorë, përditësimin e pajisjeve, rezervimin e të dhënave, menaxhimin e lejeve të aplikacioneve dhe ndarjen e sigurt të informacionit personal. Kjo tematikë synon të forcojë te nxënësi kuptimin se pakujdesia në mbrojtjen e llogarive dhe të të dhënave mund të sjellë pasoja personale, shoqërore dhe financiare.

Në tematikën "Siguria në rrjetet sociale, mediat digjitale dhe verifikimi i informacionit", nxënësi analizon ndikimin që rrjetet sociale dhe mediat digjitale ushtrojnë në formimin e opinionit, në qarkullimin e përmbajtjeve dhe në drejtimin e vëmendjes së përdoruesit. Në këtë kontekst, ai zhvillon aftësi për të verifikuar burimet e informacionit, për të dalluar clickbait-in, dezinformimin, përmbajtjet e manipuluara dhe përdorimin e imazheve ose videove jashtë kontekstit. Gjithashtu, tematika trajton rolin e algoritmeve në krijimin e flluskave informuese dhe ndikimin që ato mund të kenë në mënyrën se si individi informohet, interpreton dhe ndërton qëndrime.

Në tematikën "Etika digjitale, të drejtat dhe kuadri ligjor", nxënësi reflekton mbi përgjegjësinë personale dhe mbi parimet që rregullojnë qytetarinë digjitale. Trajtohen çështje që lidhen me privatësinë, pëlqimin për publikim, të drejtën e autorit, komunikimin etik, respektin ndaj tjetrit, si dhe pasojat që sjell shpërndarja e informacionit të dëmshëm ose e përmbajtjes pa autorizim. Kjo tematikë synon të zhvillojë te nxënësi kuptimin se hapësira digjitale është pjesë e jetës shoqërore dhe publike dhe, si e tillë, kërkon sjellje të ndërgjegjshme, të përgjegjshme dhe në përputhje me normat etike dhe ligjore.

Në tematikën "Reagimi ndaj incidenteve dhe higjiena kibernetike", nxënësi mëson të veprojë në mënyrë të sigurt, të qetë dhe të strukturuar në rastet kur përballet me incidente digjitale, si kompromentimi i një llogarie, humbja e një pajisjeje, marrja e një mesazhi të

dyshimtë, përballja me bullizëm kibernetik ose dyshimi për infektim të pajisjes. Në këtë kuadër, theksi vendoset te ruajtja e provave, raportimi i incidentit, kërkimi i ndihmës dhe ndërtimi i zakoneve të qëndrueshme të higjienës kibernetike, me synim rritjen e sigurisë personale dhe parandalimin e rreziqeve në mjedisin digjital.

Përgjatë produktit final nxënësi angazhohet në punë në grup për hartimin dhe realizimin e një produkti me vlerë ndërgjegjësuese për komunitetin shkollor në fushën e sigurisë digjitale. Projekti mund të marrë forma të ndryshme, si guidë, poster, video e shkurtër, podcast, prezantim, mini-fushatë ose workshop për bashkëmoshatarët apo për nxënës më të vegjël. Përmes këtij procesi, nxënësi jo vetëm konsolidon njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë modulit, por i transformon ato në veprim konkret dhe në kontribut të drejtpërdrejtë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kulturës së sigurisë digjitale në komunitetin shkollor.

Përmbajtja e modulit krijon mundësi për integrim ndërkurrikular me lëndë dhe fusha të ndryshme të të nxënit, duke nxitur analizën kritike, reflektimin dhe angazhimin aktiv të nxënësve të klasës së dhjetë:

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK): analizimi i kërcënimeve kibernetike, vlerësimi i rreziqeve dhe zbatimi i strategjive të ndryshme për mbrojtjen e të dhënave dhe përdorimi i sigurt i teknologjisë;

Qytetaria: zhvillimi i përgjegjësisë digjitale, etikës online dhe respektit për të drejtat e të tjerëve, si dhe angazhimi aktiv në çështje që lidhen me komunitetin digjital;

Gjuha shqipe: interpretimi dhe vlerësimi kritik i përmbajtjeve digjitale, argumentimi i qëndrimeve të bazuara në fakte dhe krijimi i materialeve ndërgjegjësuese të strukturuara dhe të mirëargumentuara;

Shkencat shoqërore: analizimi i ndikimit të teknologjisë dhe mediave digjitale në shoqëri, përfshirë fenomenet e dezinformimit, manipulimit dhe ndikimit në opinionin publik;

Arte: konceptimi dhe realizimi i produkteve krijuese (posterë, video, infografikë) me mesazhe ndërgjegjësuese, duke përdorur elemente vizuale dhe komunikative të përshtatshme për audienca të ndryshme.

3. KLASA/T KU MUND TË ZHVILLOHET MODULI

Moduli mund të zhvillohet në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë, në varësi të vendimmarrjes së shkollës. Ai ofron fleksibilitet në përshtatjen e thellësisë së përmbajtjes, të veprimtarive praktike dhe të produkteve përfundimtare, duke mundësuar që zbatimi i tij të jetë në përputhje me moshën, përvojën digjitale dhe nivelin e zhvillimit të kompetencave të

nxënësve. Ky fleksibilitet u jep mundësi shkollave ta përshtatin modulin sipas nevojave, interesave të nxënësve dhe kontekstit pedagogjik të institucionit.

4. MËSUESIT QË MUND TË ZHVILLOJNË MODULIN

Moduli rekomandohet të zhvillohet kryesisht nga mësuesit e *Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK),* pasi përmbajtja dhe tematika e tij lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e kompetencës digjitale, përdorimin e sigurt të teknologjisë, mbrojtjen e të dhënave personale dhe qytetarinë digjitale. Megjithatë, shkolla ka *fleksibilitet* në përcaktimin e mësuesve që do ta zhvillojnë modulin, në varësi të kontekstit institucional, strukturës së stafit dhe zhvillimit profesional të tij. Në këtë kuadër, moduli mund të realizohet edhe nga mësues të tjerë të formimit ndërdisiplinor, të cilët kanë kompetencat pedagogjike dhe përgatitjen e nevojshme për të udhëhequr veprimtaritë e parashikuara. Ky fleksibilitet siguron që moduli të mos kufizohet vetëm te një fushë mësimore, por të përfitojë nga ekspertiza dhe përvoja e mësuesve në funksion të rritjes së cilësisë së procesit mësimor dhe zhvillimit të kompetencave të nxënësve.

Rekomandime për mësuesit:

Gjatë zhvillimit të modulit:

- Krijoni një mjedis të sigurt, mbështetës dhe bashkëpunues, ku nxënësit të ndihen të lirshëm për të diskutuar përvoja, shqetësime dhe dilema që lidhen me përdorimin e teknologjisë dhe të internetit.
- Përdorni gjuhë të qartë dhe të saktë, duke shpjeguar termat teknikë në mënyrë të kuptueshme dhe të lidhur me situata reale nga jeta e përditshme e nxënësve.
- Nxitni të menduarit kritik, analizën dhe reflektimin, duke i udhëhequr nxënësit të mos mjaftohen vetëm me identifikimin e rrezikut, por edhe me kuptimin e shkaqeve, pasojave dhe mënyrave të reagimit.
- Përdorni shembuj, raste studimore dhe situata të afërta me realitetin e nxënësve, në mënyrë që përmbajtja e modulit të jetë sa më konkrete, domethënëse dhe e zbatueshme.
- Theksoni në mënyrë të vazhdueshme lidhjen ndërmjet sigurisë kibernetike, qytetarisë digjitale, etikës së komunikimit dhe përgjegjësisë personale në mjedisin online.
- Inkurajoni diskutime të hapura dhe të argumentuara mbi çështje si privatësia, reputacioni digjital, dezinformimi, manipulimi i informacionit, bullizmi kibernetik dhe të drejtat në mjedisin digjital.

- Fokusohuni jo vetëm te rreziqet, por edhe te masat praktike të mbrojtjes, te mënyrat e verifikimit dhe te hapat konkretë të reagimit në situata problematike.
- Jepni komente vlerësuese dhe udhëzuese gjatë gjithë procesit, duke mbështetur zhvillimin e aftësive praktike, të qëndrimeve etike dhe të përgjegjësisë digjitale te nxënësit.

Menaxhimi i situatave të ndjeshme

- Tregoni kujdes dhe ndjeshmëri gjatë trajtimit të çështjeve që mund të lidhen me përvoja personale të nxënësve, si bullizmi kibernetik, cenimi i privatësisë, mashtrimet online ose përmbajtjet shqetësuese.
- Shmangni trajtimin sensacional, alarmues ose frikësues të rasteve dhe orientoni diskutimin drejt mbështetjes, parandalimit dhe zgjidhjes.
- Inkurajoni nxënësit të kërkojnë ndihmë dhe të raportojnë situatat problematike te një i rritur i besuar, te shkolla ose te strukturat përkatëse mbështetëse.
- Respektoni privatësinë e nxënësve gjatë diskutimeve dhe shmangni ekspozimin e rasteve personale në mënyrë të drejtpërdrejtë ose identifikuese.
- Në rastet kur evidentohen shqetësime konkrete, bashkëpunoni me prindërit, psikologun e shkollës dhe strukturat e tjera mbështetëse, sipas nevojës.

Përshtatja e modulit

- Përshtatini veprimtaritë sipas nivelit të njohurive, përvojës digjitale dhe nevojave konkrete të nxënësve të klasës.
- Thelloni ose thjeshtoni trajtimin e çështjeve të caktuara në varësi të interesit të nxënësve dhe kontekstit të shkollës.
- Përzgjidhni dhe përshtatni raste studimore, skenarë dhe materiale që lidhen me realitetin e përditshëm të adoleshentëve dhe me platformat që ata përdorin më shpesh.
- Shfrytëzoni mundësitë për integrim ndërkurrikular, sidomos me qytetarinë, gjuhën shqipe dhe fusha të tjera që lidhen me analizën kritike, etikën dhe komunikimin.
- Mund të planifikoni, sipas mundësive dhe në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, përfshirjen e ekspertëve nga fusha e sigurisë kibernetike, medias, psikologjisë ose institucioneve mbështetëse, të cilët mund të kontribuojnë me njohuri dhe përvoja praktike.

5. KOHËZGJATJA E MODULIT

Moduli mund të integrohet në kurrikulën me bazë shkolle ose në kurrikulën me zgjedhje si një program i plotë prej **36 orësh** mësimore. Ai mund të zbatohet duke përfshirë veprimtaritë e sugjeruara për secilën tematikë, si dhe veprimtari të tjera që mësuesi i vlerëson të përshtatshme, në përputhje me nevojat dhe kontekstin e nxënësve.

Nr.	Tematika	Orët mësimore të sugjeruara[1]
1	Ekosistemi digjital, identiteti online dhe gjurma digjitale	4 orë
2	Kërcënimet kibernetike dhe llojet e sulmeve	6 orë
3	Mbrojtja e llogarive, fjalëkalimeve dhe të dhënave personale	6 orë
4	Siguria në rrjetet sociale, mediat digjitale dhe verifikimi i informacionit	5 orë
5	Etika digjitale, të drejtat dhe kuadri ligjor	4 orë
6	Reagimi ndaj incidenteve dhe higjiena kibernetike	5 orë
7	Projekt final dhe ndërgjegjësim në komunitet	6 orë

6. REZULTATET E TË NXËNIT

Rezultatet e të nxënit
Ekosistemi digjital, identiteti online dhe gjurma digjitale
Nxënësi: • analizon identitetin online, reputacionin digjital dhe gjurmën digjitale aktive dhe pasive në funksion të pranisë së individit në mjedisin digjital; • përshkruan të dhënat personale, të dhënat sensitive dhe informacionin që mund të ndahet në mënyrë publike; • vlerëson ndikimin që postimet, komentet, fotografitë dhe ndërveprimet online kanë në perceptimin e të tjerëve dhe në reputacionin personal; • analizon rreziqet që lidhen me ndarjen e tepruar ose të pakujdesshme të informacionit personal; • zbaton parime të sigurisë dhe të përgjegjësisë në menaxhimin e profileve personale dhe pranisë së vet digjitale; • harton rregulla personale për menaxhimin e sigurt dhe etik të identitetit të vet online.

[1] *Orët e sugjeruara për tematika janë orientuese dhe mund të përshtaten nga mësuesit, të cilët kanë fleksibilitetin të riorganizojnë kohën dhe veprimtaritë sipas nevojave të nxënësve dhe kontekstit të klasës.*

Kërcënimet kibernetike dhe llojet e sulmeve
Nxënësi: • identifikon format më të zakonshme të kërcënimeve kibernetike që shfaqen në mjedisin digjital, si phishing-u, malware-i, profilet e rreme, mashtrimet me oferta, manipulimi social dhe bullizmi kibernetik; • analizon shenjat paralajmëruese të mesazheve, lidhjeve, profileve ose skedarëve të dyshimtë; • shpjegon mënyrat se si përdoren urgjenca, frika, kurioziteti ose shpërblimi për të manipuluar përdoruesin; • analizon skenarë të cenimit të sigurisë së një individi, grupi ose komuniteti shkollor; • përdor terminologjinë bazë të sigurisë kibernetike në mënyrë të saktë dhe funksionale; • propozon masa parandaluese për zvogëlimin e rrezikut në situata të zakonshme online.
Mbrojtja e llogarive, fjalëkalimeve dhe të dhënave personale
Nxënësi: • krijon fjalëkalime ose passphrase të forta, duke shmangur zgjedhjet e parashikueshme; • shpjegon rëndësinë e përdorimit të fjalëkalimeve të ndryshme për llogari të ndryshme; • shpjegon funksionin e autentikimit me dy faktorë në mbrojtjen e llogarive; • vlerëson lejet e aplikacioneve në funksion të privatësisë dhe sigurisë personale; • zbaton praktika të sigurta për përditësimin e pajisjeve, rezervimin e të dhënave dhe ruajtjen e skedarëve; • harton një listë kontrolli personale për mbrojtjen e llogarive, pajisjeve dhe të dhënave personale.
Siguria në rrjetet sociale, mediat digjitale dhe verifikimi i informacionit
Nxënësi: • vlerëson besueshmërinë e burimeve të informacionit në mjedisin digjital; • identifikon lajmet e rreme, clickbait-in, manipulimin emocional, përmbajtjen e manipuluar dhe informacionin e nxjerrë jashtë kontekstit; • analizon ndikimin e algoritmeve në përzgjedhjen dhe shpërndarjen e informacionit; • zbaton hapa të strukturuar për verifikimin e informacionit përpara se ta besojë ose ta shpërndajë; • demonstron qëndrim kritik dhe të përgjegjshëm në përdorimin e rrjeteve sociale dhe mediave digjitale.
Etika digjitale, të drejtat dhe kuadri ligjor

Nxënësi:

- analizon kuptimin e qytetarisë digjitale në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e përdoruesit;
- dallon sjelljet e papërshtatshme online nga veprimet që cenojnë privatësinë, dinjitetin ose të drejtat e të tjerëve;
- zbaton parimet e pëlqimit, privatësisë, të drejtës së autorit dhe komunikimit etik në situata të ndryshme digjitale;
- analizon raste që lidhen me bullizmin kibernetik, shpërndarjen pa leje të përmbajtjes ose përdorimin e paautorizuar të të dhënave;
- argumenton qëndrime në dilema etike dhe juridike që lidhen me përdorimin e teknologjisë.

Reagimi ndaj incidenteve dhe higjiena kibernetike

Nxënësi:

- identifikon situata që përbëjnë incident digjital ose rrezik të menjëhershëm për sigurinë personale;
- përshkruan hapat bazë të reagimit ndaj incidenteve digjitale;
- dallon veprimet që duhen ndërmarrë dhe ato që duhen shmangur kur llogaria, pajisja ose reputacioni online rrezikohet;
- vlerëson rolin e mësuesit, prindit, shkollës dhe platformës digjitale në procesin e raportimit dhe mbështetjes;
- harton një plan të thjeshtë personal për reagim ndaj incidenteve digjitale.

Projekt final dhe ndërgjegjësim në komunitet

Nxënësi:

- përzgjedh një temë me interes për komunitetin shkollor në fushën e sigurisë kibernetike dhe qytetarisë digjitale;
- bashkëpunon në grup për planifikimin, organizimin dhe realizimin e një produkti final;
- krijon materiale ndërgjegjësuese të kuptueshme, të sakta dhe të përshtatshme për audiencën e synuar;
- prezanton gjetjet, mesazhet dhe rekomandimet në mënyrë të qartë dhe të strukturuar;
- reflekton mbi procesin e punës, kontributin personal dhe zbatueshmërinë e njohurive të fituara në jetën reale.

7. VEPRIMTARITË PRAKTIKE

Në vijim paraqiten veprimtari praktike të sugjeruara, të organizuara sipas tematikave të modulit. Këto veprimtari synojnë të mbështesin zhvillimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve në fushën e sigurisë kibernetike. Mësuesi mund t'i përzgjedhë, t'i përshtatë ose t'i plotësojë ato në varësi të nevojave të klasës, kohës në dispozicion dhe kontekstit të shkollës, duke ruajtur lidhjen me tematikat dhe rezultatet e të nxënit të modulit.

EKOSISTEMI DIGJITAL, IDENTITETI ONLINE DHE GJURMA DIGJITALE

Veprimtari: Gjurma digjitale dhe pasojat e saj

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit analizojnë mënyrën se si ndërtohet gjurma digjitale dhe vlerësojnë pasojat që ajo mund të ketë në privatësi, reputacion dhe mundësi personale e profesionale.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi e nis veprimtarinë me një pyetje problemore: *"A është interneti një hapësirë ku gjërat harrohen shpejt, apo një hapësirë ku gjithçka mund të mbetet?"* Mbi këtë pyetje zhvillohet një diskutim i shkurtër hyrës, ku nxënësit reflektojnë mbi përvojat e tyre dhe mbi mënyrën si krijohen gjurmët digjitale. Në vijim, mësuesi prezanton shkurt dallimin ndërmjet gjurmës digjitale aktive dhe asaj pasive, duke e lidhur me shembuj konkretë nga përdorimi i përditshëm i teknologjisë: postime, komente, kërkime, regjistrime në platforma, përdorim aplikacionesh, vendndodhje, cookies, historik klikimesh etj.

Më pas, nxënësit punojnë në grupe dhe analizojnë disa situata të përgatitura nga mësuesi, si p.sh.:

- një koment i shkruar me nxitim në një rrjet social;
- publikimi i një fotografie pa menduar për audiencën;
- regjistrimi në një platformë me të dhëna të panevojshme;
- përdorimi i një aplikacioni që mbledh shumë të dhëna personale;
- shpërndarja e një përmbajtjeje që më vonë hiqet, por mbetet e ruajtur diku tjetër.

Për secilin rast, nxënësit diskutojnë:

- Çfarë gjurme lë ky veprim?
- Kush mund ta përdorë ose ta shohë këtë informacion?
- Cilat mund të jenë pasojat afatshkurtra dhe afatgjata?
- Si mund të shmangej ose të reduktohej kjo gjurmë?

Në vijim, secili grup ndërton një skemë analitike ku lidh: ***veprimin digjital → gjurmën e lënë → pasojën e mundshme → masën parandaluese.***

Në fund, zhvillohet një reflektim i përbashkët mbi faktin se gjurma digjitale nuk ndikon vetëm në sigurinë personale, por edhe në mënyrën si ndërtohet identiteti dhe reputacioni i individit në mjedisin digjital.

Produkti i mundshëm:

- Skemë analitike e gjurmës digjitale dhe pasojave të saj;
- Reflektim individual: *"Si mund ta menaxhoj më me kujdes gjurmën time digjitale?"*

Veprimtari: Auditimi i pranisë digjitale

***Qëllimi i veprimtarisë*:** Nxënësit analizojnë një profil digjital të simuluar, identifikojnë elementet që mund të ndikojnë në privatësi dhe reputacion, si dhe propozojnë mënyra për ta bërë atë më të sigurt dhe më të përshtatshëm.

Përshkrimi i veprimtarisë: Veprimtaria nis me një pyetje hyrëse nga mësuesi: **"***Çfarë mund të kuptojë dikush për një person vetëm duke parë profilin e tij online?"* Përmes një diskutimi të shkurtër, nxënësit rikujtojnë se prania digjitale ndërtohet nga postimet, komentet, fotografitë, pëlqimet, ndjekësit, gjuha e përdorur dhe mënyra si menaxhohen cilësimet e privatësisë.

Më pas, mësuesi paraqet një profil digjital të simuluar, të ndërtuar posaçërisht për këtë veprimtari. Profili mund të përfshijë:

- fotografi profili dhe përshkrim personal;
- disa postime publike;
- komente ose reagime ndaj postimeve;
- lista interesash;
- informacione personale të dukshme;
- cilësime privatësie.

Në vijim, nxënësit ndahen në grupe dhe punojnë me një **fletë auditimi**, ku analizojnë profilin sipas disa treguesve të qartë. Për secilin element, ata përcaktojnë:

- çfarë informacioni jep ai për personin;
- nëse përbën rrezik për privatësinë;
- nëse mund të ndikojë në reputacionin digjital;
- çfarë do të duhej ndryshuar.

Për ta bërë analizën më të strukturuar, grupet mund të përdorin një vlerësim të thjeshtë:

- ✓ rrezik i ulët,
- ✓ rrezik mesatar,
- ✓ rrezik i lartë.

Pas analizës, secili grup përzgjedh:

- 3 elementet më problematike të profilit;
- 3 rekomandime konkrete për përmirësim.

Më pas, grupet prezantojnë gjetjet e tyre para klasës. Mësuesi udhëheq diskutimin duke i ndihmuar nxënësit të kuptojnë se prania digjitale nuk ndikon vetëm në mënyrën si paraqitemi online, por edhe në reputacionin, marrëdhëniet dhe mundësitë tona në të ardhmen.

Në përfundim, secili nxënës plotëson individualisht një reflektim të shkurtër me pyetjen: *"Çfarë duhet të kem parasysh për ta menaxhuar më me kujdes praninë time digjitale?"*

Produkti i mundshëm:

- Fletë auditimi e profilit digjital;
- Listë me 3 problemet kryesore dhe 3 rekomandime për përmirësim;
- Reflektim individual mbi menaxhimin e pranisë digjitale.

Veprimtari: Reputacioni digjital në të ardhmen

***Qëllimi i veprimtarisë*:** Nxënësit vlerësojnë ndikimin që prania dhe sjellja digjitale mund të kenë në mundësitë e tyre akademike, profesionale dhe shoqërore në të ardhmen.

Përshkrimi i veprimtarisë: Veprimtaria nis me një pyetje nga mësuesi: **"***A mund të ndikojë ajo që postojmë sot në mundësitë tona nesër?"* Nxënësit japin mendime dhe ndajnë shembuj nga përvoja e tyre ose nga raste që kanë dëgjuar.

Më pas, mësuesi paraqet 2–3 skenarë të shkurtër, si p.sh.:

- një nxënës që aplikon për bursë ose shkëmbim studentor dhe profili i tij publik përmban gjuhë fyese ose postime të papërshtatshme;
- një i ri që kërkon një punë të parë dhe ka lënë online komente diskriminuese ose tallëse;
- një nxënës që ka ndërtuar një profil digjital pozitiv përmes përmbajtjeve krijuese, aktiviteteve dhe komunikimit të përgjegjshëm.

Në grupe, nxënësit analizojnë secilin rast dhe diskutojnë:

- Çfarë përshtypjeje krijon ky profil?
- Cilat elemente ndikojnë pozitivisht ose negativisht?
- Si mund të ndryshojë reputacioni digjital mundësitë e këtij personi?
- Çfarë do të rekomandonin për ta përmirësuar praninë e tij digjitale?

Në vijim, grupet prezantojnë përfundimet e tyre dhe mësuesi thekson se reputacioni digjital nuk lidhet vetëm me rrezikun, por edhe me mënyrën si ndërtojmë besueshmëri, seriozitet dhe identitet në mjedisin online.

Në fund, secili nxënës shkruan një reflektim të shkurtër me temë: *"Si dua të duket prania ime digjitale pas 5 vitesh?"*

Produkti i mundshëm:

- Analizë e shkurtër e një skenari;
- Reflektim individual mbi reputacionin digjital në të ardhmen.

KËRCËNIMET KIBERNETIKE DHE LLOJET E SULMEVE

Veprimtari: Detektivët e phishing-ut

***Qëllimi i veprimtarisë*:** Nxënësit analizojnë mesazhe dhe email-e të ndryshme për të identifikuar shenjat paralajmëruese të phishing-ut dhe për të dalluar komunikimin e besueshëm nga ai mashtrues.

***Përshkrimi i veprimtarisë*:** Veprimtaria nis me paraqitjen nga mësuesi të disa shembujve të printuar ose të projektuar të mesazheve dhe email-eve, ku disa janë legjitime dhe disa të tjera përmbajnë elemente tipike të phishing-ut. Fillimisht, nxënësit i vëzhgojnë rastet individualisht dhe shënojnë elementet që u duken të dyshimta.

Më pas, nxënësit punojnë në grupe dhe përdorin një fletë analize për të vlerësuar secilin shembull sipas disa treguesve, si:

- adresa e dërguesit;
- toni urgjent ose kërcënues;
- gabimet gjuhësore;
- kërkesa për klikim të menjëhershëm;
- kërkesa për ndarjen e të dhënave personale;
- lidhje ose bashkëngjitje të dyshimta.

Për secilin rast, grupet vendosin nëse mesazhi është:

- ✓ i besueshëm;
- ✓ i dyshimtë;
- ✓ i rrezikshëm,

dhe argumentojnë vendimin e tyre. Në vijim, grupet prezantojnë analizën para klasës dhe mësuesi përmbledh në tabelë shenjat më të zakonshme paralajmëruese të phishing-ut.

Për ta forcuar veprimtarinë, mësuesi mund të shtojë edhe një hap krahasues, ku nxënësit analizojnë dallimin ndërmjet:

- adresës reale dhe adresës së manipuluar të një domeni;
- lidhjeve të plota dhe lidhjeve të shkurtuara;
- gjuhës zyrtare dhe gjuhës manipuluese në komunikimin digjital.

Produkti i mundshëm:

- Tabelë klasifikimi e rasteve;
- Listë ose poster me titull: **"***Shenjat paralajmëruese të një mesazhi phishing."*

Veprimtari: Loja me role "Manipulimi social"

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit analizojnë mekanizmat e manipulimit social dhe vlerësojnë mënyrat e reagimit të sigurt ndaj situatave që synojnë marrjen e informacionit ose cenimin e sigurisë personale.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi e nis veprimtarinë duke shpjeguar shkurt se shumë sulme digjitale nuk mbështeten vetëm te mjetet teknike, por edhe te manipulimi i përdoruesit përmes emocioneve, besimit, nxitimit ose frikës.

Më pas, nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet një skenar i ndryshëm, si p.sh.:

- një person që prezantohet si administrator platforme;
- një shok i rremë që kërkon kod verifikimi;
- një konkurs fitues që kërkon të dhëna personale;
- një mesazh që nxit frikë për të marrë informacion;
- një telefonatë ose komunikim që kërkon veprim të menjëhershëm.

Grupet analizojnë skenarin duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Cilat emocione ose reagime synon të nxisë ky komunikim?
- Cili është rreziku kryesor?
- Çfarë elementi e bën mesazhin bindës?
- Si duhet të reagojë një nxënës në mënyrë të sigurt dhe të arsyetuar?

Në vijim, grupet paraqesin skenarin dhe zgjidhjen përpara klasës. Mësuesi e orienton diskutimin drejt kuptimit se manipulimi social funksionon pikërisht sepse shfrytëzon dobësi njerëzore, si besimi, kureshtja, frika ose nxitimi. Mësuesi mund t'u kërkojë nxënësve të identifikojnë për secilin rast teknikën e manipulimit të përdorur, objektivin e sulmit, si dhe masën parandaluese më efektive.

Produkti i mundshëm:

- Kartë-zgjidhje për skenarin e analizuar;
- Fjalor i shkurtër me taktikat më të zakonshme të manipulimit social.

Veprimtari: Klasifikimi i kërcënimeve në jetën e përditshme

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit klasifikojnë kërcënime të ndryshme digjitale sipas natyrës së tyre dhe propozojnë masa parandaluese në situata të afërta me jetën e përditshme të adoleshentëve.

Përshkrimi i veprimtarisë: Mësuesi paraqet një seri rastesh të shkurtra që lidhen me përvojat digjitale të përditshme të të rinjve, si:

- lidhje të dyshimta në chat;
- lojëra ose aplikacione që kërkojnë leje të tepërta;
- profile të rreme në rrjetet sociale;
- mesazhe bullizuese;
- skedarë të paautorizuar të dërguar me email;
- reklama mashtruese ose oferta joshëse;
- kërkesa të papritura për kod verifikimi ose të dhëna hyrjeje.

Nxënësit punojnë në grupe dhe i rendisin rastet sipas llojit të kërcënimit, p.sh.:

- rrezik teknik;
- rrezik social;
- rrezik emocional;
- rrezik për privatësinë;
- rrezik për reputacionin.

Për secilin rast, ata propozojnë edhe masat parandaluese që mund të ndihmojnë në shmangien ose zvogëlimin e rrezikut. Grupet prezantojnë skemat e tyre dhe i krahasojnë me ato të grupeve të tjera.

Në përfundim, mësuesi përmbledh idenë se kërcënimet digjitale nuk paraqiten gjithmonë në të njëjtën formë dhe se përdoruesi duhet të zhvillojë aftësinë për t'i njohur, klasifikuar dhe trajtuar ato në mënyrë të vetëdijshme.

Produkti i mundshëm:

- Skemë klasifikuese e kërcënimeve;
- Listë e masave parandaluese për secilin rast.

Veprimtari: Analiza e filmit interaktiv "No Escape Room"

Qëllimi i veprimtarisë: Nxënësit analizojnë mekanizmat e manipulimit dhe të presionit që përdoren në mjedisin digjital, si dhe reflektojnë mbi mënyrat e reagimit të sigurt dhe të përgjegjshëm në situata të rrezikshme online.

Përshkrimi i veprimtarisë: Veprimtaria zhvillohet mbi bazën e filmit interaktiv **"No Escape Room"**, një burim edukativ online që paraqet, në formë të ndërveprueshme, mënyrën se si një i ri mund të manipulohet dhe të përfshihet në një situatë shantazhi ose sextortion-i në internet. Mësuesi e prezanton shkurt burimin dhe orienton nxënësit të vëzhgojnë me kujdes mënyrën se

si ndërtohet besimi, si përdoren profilet e rreme, si krijohet presioni psikologjik dhe si përshkallëzohet situata.

Pas ndjekjes së materialit, nxënësit punojnë në grupe dhe diskutojnë pyetje të tilla si:

- Cilat taktika manipulimi u përdorën në këtë rast?
- Cilat ishin shenjat paralajmëruese që personazhi mund të kishte dalluar më herët?
- Në cilat momente situata mund të ishte ndalur?
- Çfarë duhet të bëjë një i ri kur përballet me një situatë të ngjashme?
- Cili është roli i raportimit dhe i kërkimit të ndihmës?

